

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVËNDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.Br.4/2024	Data: 31.01.2024	

Në bazë të nenit 11 dhe 12 paragrafi 12.2 pika (d), neni 17 paragrafi 1 shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 Qershor 2008), neni 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1 lidhur me nenin 10, paragrafi 2, pika 2.2, neni 11 dhe 16 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor duke pasur parasysh Vendimin Nr.21/1295 të datës 21.06.2021 për pëlqimin Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Istogut, dhe në pajtim me nenin 34.2. të Statutit të Komunës, 01.Nr.62/10 si edhe Vendimit për Dhënien e Pëlqimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Istogut 2023-2031 sipas kërkesës së 07.04.2023 me Nr.Prot.1898/23 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr.1898-2/23 të datës 14.12.2023, si dhe pas rishqyrtimit të vendimit Nr.210/23 të datës 28.12.2023 me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, që në mbledhjen e mbajtur të datë 31.01.2024 e miratojnë këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS
SE ISTOGUT (HZK) PËR PERIUdhËN 2024 – 2032

1. Miratohet vendimi për Hartën Zonale të Komunës së Istogut për periudhën tete (8) vjeçare 2024-2032, si një dokument gjithëpërfshirës që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Istogut.
2. Me Hartën Zonale të Komunës së Istogut përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësin për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Istogut.
3. Më hartën zonale të Komunës së Istogut për periudhën 2024-2032 nga pika 1 e këtij Vendimi përmban pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike, Raportin e vlerësimit Strategjik Mjedisor, Raportin e Shqyrtimit publik dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.



4. Harta Zonale e Komunës së Istogut do të mbuloj sipërfaqen e territorit të Komunës së Istogut prej $S=453.84 \text{ km}^2$ dhe do të përfshi të gjitha Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunës.
5. Me hyrjen në fuqi të Hartës Zonale të Komunës së Istogut 2024 -2032 e njëjta do të mbizotëroj ndaj çfarëdo Planit të mëhershëm të zhvillimit urban ose planit të mëhershëm rregullues Urban.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mjedis.
7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit
Z. Enver Rugova